



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/44
Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 40 dhe 41 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/44

Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushëveprimtarisë së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/44

Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 3. dhe të nenit 25 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për autorizimin e Avokaturës Shtetërore si organ qendror i administratës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, që të bartë lëndët e regjistruara dhe të bëjë delegimin e kompetencave dhe përgjegjësive të përfaqësimit në kontestet pasurore-juridike, administrative dhe të arbitrazhit, tek autoritetet publike për të cilat Ministria e Drejtësisë ka të drejtën dhe autorizimin, por jo detyrimin e përfaqësimit në gjykata dhe organe të tjera.
2. Delegimi i kompetencave si dhe përfaqësimi në kontestet pasurore-juridike, sipas pikës 1. të këtij vendimi, do të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara në paragrafin 6 të nenit 10. të Ligjit Nr. 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, si dhe dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221 si dhe me Ligjin Nr. 03/L-048.
3. Obligohet Ministria e Drejtësisë, përkatësisht Avokatura Shtetërore, që të realizojë bartjen e lëndëve të regjistruara në bazë të pikës 1. të këtij vendimi, të hartojë planin e veprimit për adresimin e aspekteve të ndryshme administrative dhe institucionale për zbatimin e këtij vendimi, të përpilojë një regjistër të lëndëve të bartura si dhe të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse publike të cilat autorizohen për përfaqësim në bazë të pikës 1. të këtij vendimi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë, përkatësisht Avokatura Shtetërore, që të njoftojë zyrtarisht Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe të gjitha autoritetet publike të cilave iu delegon kompetencat dhe përgjegjësitë për përfaqësim në kontestet pasurore-juridike, administrative dhe të arbitrazhit për efektet juridike të këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/44

Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Administratës Publike, me nr. prot. 1261, datë 18.04.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Nehat Thaqi emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 5 (pesë) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/44

Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Trajtimin e Kuadrit Ligjor të Tatimeve dhe Procedurave në Fushëveprimin e Administratës Tatimore të Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/44


Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 45 të Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Tremujor i Buxhetit për vitin 2018.
2. Raporti nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/44

Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021.
2. Korniza nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/44

Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-175 për Borxhet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi i Borxhit Shtetëror për vitet 2019-2021.
2. Programi nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 09/44

Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neneve 10 dhe 11 të "Marrëveshjes Kornizë" të nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian "Mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën, në kuadër të instrumentit të asistencës së para-anëtarësimit IPA-II, të paragrafit 10 dhe 14 të Vendimit të Qeverisë nr. 6/121 të datës 22.04.2010, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ministrja e Integritimit Evropian, emërohet Koordinator Nacional për donacione, IPA, TAIEX dhe programe të tjera që ofrojnë donacione për Republikën e Kosovës.
2. Me këtë vendim shfuqizohet pika 3.1. e Vendimit të Qeverisë nr. 10/141 datë 07.04.2017 dhe zëvendësohet me tekstin në pikën 1. të këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/44
Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 40,000,00 (dyzet mijë) euro për komunitetin kroat që jeton në Janjevë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Zyrën e Kryeministrit, kodi organizativ 104 - nën programi: 10600 në kategorinë subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me Rregulloren (MF) nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë